

Job Description- Shop Representative

Dëshiron të bëhesh pjesë e FinTech-ut të parë shqiptar? Ne në EasyPay po kërkojmë një "Shop Representative" i cili do ti bashkohet grupit tonë gjithnjë e në rritje. Do të jeni pjesë e kompanisë së parë FinTech në Shqipëri, e cila renditet në listën e "Top 3" kompanive FinTech më të mira në Europë dhe është vlerësuar si "Best Payment Solution Provider Albania 2020" nga Global Banking and Finance Review.

Detyrat Kryesore:

- Kryeni pagesat nga sistemet e EasyPay për të gjitha shërbimet e ofruara sipas kërkesave të klientëve, duke ndjekur me përpikmëri të gjitha hapat e përcaktuara në procedurën e brendëshme
- Tu përgjigjeni klientëve për problemet e ndryshme që ata reklamojnë, orientoni zgjidhjen e tyre në departamentet përkatëse;
- Kryeni këmbim valutash sipas kërkesave të klientëve;
- Kryeni procesin e shërbimit të transfertave duke shërbyer klientët që paraqiten në dyqan;
- Përgjegjës për shitjet në dyqan të gjitha pajisjeve fizike;
- Përgjegjës për mbajtjen e arkës duke kryer rakordimet ditore me kolegun e turnit pasues.

Kualifikimet që duhet të keni:

- Arsim i Lartë / Bachelor;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Njohuri dhe eksperiencë mbi sistemin e pagesave elektronike, apo në kompani me profil të ngjashëm;
- Njohuri të mira mbi paketën Office 2010;
- Aftësi shumë të mira komunikimi, të tregoni se mendoni dhe mësoni shpejt duke treguar qetësi dhe maturi;
- Fleksibilitet për të kapërcyer sfidat e përditshme dhe të jeni të mirë organizuar në detaje;
- Aftësi të mira në menaxhimin e kohës në mënyrë efektive;
- Përkushtimin e duhur në punë, përgjegjshmërinë, iniciativa për të kryer sakte detyrat individuale si dhe të jeni i gatshëm të punoni në grup.

Dokumentacioni paraprak: CV, Kopje të Certifikatave, Diploma të kualifikimeve të ndryshme duhet të dërgohen me e-mail në adresën: hr@easypay.al

Afati i pranimit të aplikimeve: 10 Tetor 2021!

*Do të lajmërohen për intervistë vetëm kandidatët që do të perzgjidhen.